

Republika e Kosovës
Republika Kosovo/ Republic of Kosovo
Komuna Rahovec - Opštine Orahovac

Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë - Sektori për pronë
Odeljenje za Katastar, Geodeziju i Imovinu - Sektor za imovinu

Data - Datum	26.05.2020
Referencë/a	08 nr. 15/2020
Për/Za/To :	Naser Nebih Shala nga Krusha e Madhe
Zona Kadastrale:	Krushë e Madhe
Përmes/ Prekp/Through:	Afrim Oruqi - Drejtor
Nga/Od/From/	Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi, dhe Pronë
Subjekt/Subekat/Subject:	Sektori për Pronë
	Vendim për Uzurpim

Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë - Sektori për pronë K.K. Rahovec duke vendosur sipas kërkesës së Drejtorisë për Punë Inspektuese – Inspektori i Ndërtimtarisë 14 nr. 1028/2020 më datë: 06.03.2020, me të cilën është kërkuar që të zhvillohet procedura e uzurpimit arbitrar në pronësinë shtetërore, kundër të dyshuarit „Naser Nebih Shala nga Krusha e Madhe, në bazë të nenit 16, 17 dhe 18 të Ligjit Mbi Shqyrtimin e Marrëdhënieve Pasurore të krijuar me uzurpim arbitrar të tokës në pronësinë shtetërore (“ Gazeta zyrtare e KASK ”, nr. 46/77 dhe 37/88), dhe nenit 21 të Ligjit mbi Procedurën Administrative nr. 05/L-031, merr:

V E N D I M

I. VERTETOHET Se Naser Nebih Shala nga Krusha e Madhe, me ndërtimin e objektit për banim, në dimensione prej 12m me 5.5m, ka bërë zgjerimin e parcelës së vet, nr.534-2, në dem parcelën shtetërore nr.2763,Zona Kadastrale në Krushë të Madhe, e cila evidentohet si P.Sh.e Kosovës K.K Rahovec-Rrugë, duke bërë uzurpim arbitrar të pasurisë shtetërore, në sipërfaqe të përgjithshme 12 m².

II. Uzurpuesi arbitrar, Naser Nebih Shala nga Krusha e Madhe, është i obliguar që pjesën e parcelës së uzurpuara ta liroj me mënjanimin e objektit të ndërtuara, të cekura në pikën **I** të këtij vendimi dhe të njëjtën ta kthej në gjendjen e mëparshme, në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë të këtij vendimi.

III. Nëse i përmenduri në afatin e caktuar ligjor nuk e liron sipërfaqen e uzurpuar, vendimi do të ekzekutohet në mënyrë të dhunshme.

IV. Uzurpimi është kryer në vitin 2019-2020.

V. Shpenzimet e procedurës bien në barrë të uzurpuesit arbitrar.

A r s y e t i m

Inspektori i ndërtimtarisë me kërkesën 14 nr. 1028-2020 më datë: 06.03.2020 ka njoftuar këtë drejtori se gjatë mbikëqyrjes së rregullt inspektuese mbi ndërtimin e objekteve pa leje në Komunën e Rahovecit, përkatësisht në fshatin Krushë e Madhe, ka hasur tek Naser Nebih Shala nga Krusha e Madhe, ndërtimin e objektit të cekura në pikën **I** në dispozitivin e këtij vendimi, për çka dyshohet se ky ndërtim është bërë në pjesën e parcelën komunale nr. 2763-0 dhe ka kërkuar nga kjo drejtori të vërtetohet gjendja faktike në vendin e ngjarjes.

Drejtorja për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë – Sektori për Pronë i K.K. Rahovec së bashku me gjeodetën e kësaj drejtorie kanë dalë në vendin e ngjarjes dhe pas matjes dhe incizimit së parcelës komunale nr. 2763-0, ka konstatuar se i përmenduri me veprimet që ka ndërmarr ka bërë uzurpim arbitrar në parcelën komunale në të cilën eksperti i gjeodezisë ka hartuar skicën e terrenit, me të cilën shihet qartë pozita, kufiri dhe sipërfaqja e uzurpuar.

Për shkak të pandemisë Covid-19, nuk është marrë deklarata nga pala.

Kjo drejtori ka analizuar dhe vlerësuar faktet dhe në fund ka vendosur në këtë çështje administrative, pasi që gjatë matjes dhe incizimit të parcelës në fjalë të pasqyruar në skicën e terrenit, është vërtetuar se i përmenduri ka bërë uzurpim arbitrar.

Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe administrimit të provave, në bazë të nenit 16, 17 dhe 18 të Ligjit mbi shqyrtim e marrëdhënieve pasurore të krijuar me uzurpim të tokës në pronësi shtetërore (“ Gazeta Zyrtare e KASK”, 46/77 dhe 37/88 ”), është vërtetuar se i përmenduri ka bërë uzurpim arbitrar në parcelën komunale, të cekur në dispozitiv të këtij vendimi.


U vendos pranë Drejtorisë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë – Sektori i Pronës Kuvendi Komunal Rahovec, më datë 26.05.2020

08 nr. 15/2020

KESHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi mund të parashtrohet ankesë në Agjencinë Kadastrale të Kosovës - Prishtinë, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimiit përmes kësaj drejtorie.

Hartuesi

Jurist i Diplomuar.



Nazmi Krasniqi



Drejtori

Jurist Diplomuar.



Afrim Oruqi